



**Kalendari i trajnimit për kandidatët
e Vitit të Tretë**

Janar – Dhjetor 2021

Kalendari i trajnimit për Kandidatët e Vitit të Tretë

Organizuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Janar – Dhjetor 2021, IEKA, Tiranë

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët ndjekin edukimin profesional të avancuar që realizohet me pjesëmarrjen në trajnime, leksione, seminare dhe testimet përkatëse për njohuritë e aftësitë profesionale, sipas moduleve që përmban programi.

Programi i studimeve post master për marrjen e titullit “Auditues Ligjor” realizohet nga dhe pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite kalendarike;

Disiplinat dhe veprimtaritë e tjera formuese, që zhvillohen në këtë program studimi gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, përfshijnë modulet profesionale të një niveli të avancuar, si më poshtë:

1. Moduli Raportimi Financiar i Avancuar;
2. Moduli Taksimi i Avancuar;
3. Moduli Legjislacioni i Biznesit i Avancuar;
4. Moduli Auditim dhe Dhënie Sigurie i Avancuar
5. Moduli Drejtimi i Performancës i Avancuar
6. Moduli Etika Profesionale.

Këshilli Drejtues ka miratuar kalendarin e trajnimit për kandidatët e vitit të tretë, sipas disiplinave më poshtë:

Moduli 14 – 23 Qershor 2021	Moduli 6 – 11 Shtator 2021	Moduli 18–30 Tetor 2021
Drejtimi i Performancës së Avancuar	Etika Profesionale	Auditim dhe Shërbimet e Dhënies së Sigurisë së Avancuar
Testimi 30 Qershor 2021 Ritestimi 7 Korrik 2021	Testimi 18 Shtator 2021 Ritestimi 25 Shtator 2021	Testimi 10 Nëntor 2021 Ritestimi 24 Nëntor 2021

Nëse do të ketë ndryshime nga programi, ju do njoftoheni nëpërmjet emailit.

Trajnimet kryhen online nëpërmjet aplikacionit ZOOM Webinar. Përpara zhvillimit të trajnimit, ju do të merrni instruksionet e nevojshme nga sektori i edukimit.

Frekuentimi i leksioneve të moduleve profesionale është i detyrueshëm në masën 75%, ndërsa frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.

Dëshërojmë tju kujtojmë se Kandidati fiton të drejtën të hyjë në testimin përfundimtar të një moduli kur ka shlyer të gjitha detyrimet që lidhen me atë modul, përfshirë detyrimet financiare ndaj IEKAs.

Tarifa e trajnimit është 30.000 lekë/vit dhe afati i pagesës është deri në 30 qershor.

Dokumentat që duhet të dorëzoni në IEKA gjatë praktikës profesionale

Të gjithë kandidatët që ndjekin praktikën profesionale për Auditues Ligjor duhet të depozitojnë në Institut brënda datës **10 Janar** dokumentat që vërtetojnë kryerjen e praktikës profesionale për vitin paraardhës.

- Vlerësimi nga drejtuesi i praktikës profesionale (nënshkruar dhe vulosur nga drejtuesi i praktikës profesionale);
- Ditari i praktikës profesionale për periudhën 1 Janar 202X – 31 Dhjetor 202X (nënshkruar nga kandidati dhe drejtuesi, vulosur nga drejtuesi i praktikës profesionale);
- Kopje të listëpagesave e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi, (formulari E-SIG 025) Janar - Dhjetor 202X.
- Listëpagesën e muajit dhjetor mund ta dorëzoni pas datës 20 Janar.
- Vlerësimi nga drejtuesi i praktikës profesionale dorëzohet **cdo 6 muaj**.

Në periudhën shtator – nëntor të vitit të fundit të praktikës profesionale, kandidatët të cilët kanë kaluar me sukses testet në modulet profesionale do të depozitojnë dhe mbrojnë **një punim profesional** që përfshin trajtime teorike e praktike në çështje me interes për profesionin.

Ju urojmë Suksese!
Stafi Ekzekutiv i IEKAs